



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 24.

Prishtinë, më 24.11.2015 në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivković, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavljeviq, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Danush Ademi dhe Veton Berisha.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi, përfaqësuese nga OSBE-ja; Melina Muriq, gazetare e RTK-së, programi në gjuhën serbe; Albana Bajrami, gazetare e RTK-së; Ismail Shabani, gazetar nga “Kosova Press”; Artan Murati, përfaqësues i KAAD-it dhe Celal Iliaz, përfaqësues nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: - Natasa Prica-Tishma, koordinatore; Drita Çarkaxhiu, zyrtare e lartë ligjore.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivković**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi i Draft-raportit të grupit punues lidhur me monitorimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-05 8 për Dizajnin industrial me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
5. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;**
6. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Draft-raportit të grupit punues lidhur me monitorimin e Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe

Kryesuesja theksoi se grupi punues ka zhvilluar, në të gjitha fazat, procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit dhe Ligjin për fshatin Hoçë e Madhe. Duke pasur parasysh gjetjen nga takimet dhe vizitat në terren, grupi punues ka evidentuar se është formuar Këshilli për Trashëgiminë Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit dhe Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe, si mekanizëm i ruajtjes së trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Gjatë monitorimit, janë vërejtur disa parregullsi, siç janë moszbatimi i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me buxhetin e këshillave. Për arsye të lartcekura, kërkohet që të parashihet ndarja e mjeteve buxhetore për funksionim të plotë të Këshillit, nga buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të zbatimit të Ligjit nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe dhe Ligjit nr. 04/L-066 për Qendrën Historike të Prizrenit dhe rritjes së përgjegjësisë institucionale, propozohen rekomandimet, si në vijim:

Rekomandime

1. Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, në fazën e hershme të përgatitjes së planit të buxhetit të Republikës së Kosovës, të parashohë mjete buxhetore për buxhetimin e këshillave funksionale të fshatit Hoçë e Madhe dhe të Këshillit për Trashëgimi Kulturore të Qendrës Historike të Prizrenit, për çdo vit kalendarik.
2. Rekomandohet që Qeveria e Republikës së Kosovës, në koordinim me pushtetin lokal të Komunës së Prizrenit dhe të Komunës së Rahovecit, me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve adekuate, të inkorporojë një program-kod të posaçëm për implementimin e financimit të këtyre këshillave funksionale.
3. Me qëllim të përcjelljes periodike dhe të mbikëqyrjes së buxhetit, obligohen këta këshilla, që njëherë në muaj, të informojnë Ministrinë e Planifikimit Hapësinor për ekzekutimin buxheteve të tyre, në pajtim me rregullat financiare për raportim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-05 8 për Dizajnin industrial, me amendamentet e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryesuesja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 05/L-05 8 për Dizajnin industrial dhe kërkoi nga anëtarët e Komisioni që të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në rekomandimin, i cili do t'i dërgohet Komisionit funksional.

Meqë nuk kishte vërejtje në projektligj, pas shqyrtimit të raportit me amendamente të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-05 8 për Dizajnin industrial dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, me raport- amendamente të Komisionit funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje në projektligj, pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-051 për Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore, me raport- amendamente të Komisionit funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Meqë nuk kishte vërejtje në këtë projektligj, pas shqyrtimit të raportit me amendament të Komisionit funksional, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, shqyrtoi Projektligjin nr. 05/L-057 për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.
- II. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Të ndryshme

Veton Berisha, kërkoi që të ftohet ministri i MAP, z. Mahir Jagcilar, për të raportuar lidhur me monitorimin e Ligjit për shërbimin civil, neni 11, gjegjësisht dhënien e informatave për numrin e të punësuarve në shërbimin publik dhe privat.

Pas diskutimeve, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

Përfundim

Ngarkohet shërbimi i sekretarisë së Komisionit që të ftojë ministrin, z. Mahir Jagcilar, me qëllim të raportimit lidhur me Ligjin për shërbimin civil, gjegjësisht nenin 11. Gjithashtu, të kërkohet përgjigjja zyrtare për datën dhe ditën e pjesëmarrjes në takim të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Jasmina Zhivković